



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 168 AKTI

NR. 168 VENDIMI

Tiranë, më 25.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, më datë 20.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Behar Dibra**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE :** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”).

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “ligji nr. 84/2016”);

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, z. **Behar Y. Dibra**, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, detyrë të cilën e ka filluar në muajin janar të vitit 2004 dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Ai i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 17.9.2018 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 2.10.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi, znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Behar Dibra.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)** ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshëhje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me

personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 17.05.2019, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Behar Dibra.*

**Këshilli i Lartë i Prokurorisë** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2019.

Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 7.6.2019 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 12.6.2019.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 14.6.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 20.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht, duke shprehur opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Behar Dibra ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i

gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

##### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Apartament 1+1, me sipërfaqe 62.72 m<sup>2</sup>, ndodhur në katin e \*\*\* të godinës \*\*\*-katëshe, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë në dhjetor 2011, në shumën 5.000.000 lekë, i rivlerësuar, me raport rivlerësimi, datë 31.5.2013.

Burimi i Krijimit sipas deklaratës “Vetting”: kredi në “BKT”.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\*, dt. 29.4.2013;
- Kontestim kontrate, datë 30.4.2013, drejtuar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k;
- Kontratë sipërmarrje, datë 16.6.2002, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k dhe znj. Sh. D;
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* datë 7.12.2011;
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* datë 7.12.2011;
- Dokumentacion në lidhje me lejen e ndërtimit të pallatit ku ndodhet apartamenti;
- Kontratë sipërmarrje, nr. \*\*\*, datë. 9.12.2011;
- Vërtetim hipotekor, nr. \*\*\*, datë 3.5.2013;
- Raport vlerësimi pasurie, datë 29.5.2013, për apartamentin me sipërfaqe 62.72 m<sup>2</sup> + kërkesë për aplikim, datë 31.5.2016, për rivlerësim pasurie + mandat “Credins Bank” për pagesat e rivlerësimit;
- Kontratë porosie, nr. \*\*\*, datë 3.5.2011;

- Revokim kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 7.12.2011, porositës Behar Dibra dhe sipërmarrës shoqëria “\*\*\*\*”sh.p.k, të një apartamenti me sipërfaqe 86.87 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Dajt, në vlerën 6.500.000 lekë. Palët kanë rënë dakord për revokimin e kontratës dhe për kthimin e shumës prej 1.500.000 lekë, duke mos patur asnjë detyrim midis tyre;
- Vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, nga “BKT Bank”;
- Kontratë kredie, nr. \*\*\*, datë 23.11.2011;
- Nxjertje llogarie nga “BKT Bank”.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Kthim përgjigje ZVRPP-ja Tiranë, nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2018;
- Kthim përgjigje ZVRPP-ja Shkodër, nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2018;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar OSHEE-së;
- Kthim përgjigje OSHEE-ja, nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2018;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar UKT-së;
- Kthim përgjigje UKT-ja, nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2018;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2019, drejtuar UKT-së;
- Kthim përgjigje UKT-ja nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Kthim përgjigje DPPP-ja, nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar Agjencisë së Trajtitimit të Pronave;
- Kthim përgjigje ATP-ja, nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2018;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar bankave;
- Kthim Përgjigje BKT-ja, nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2018;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2019, drejtuar BKT-së;
- Kthim përgjigje BKT-ja, nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2019, drejtuar “\*\*\*\*” sh.p.k;
- Kthim përgjigje \*\*\* sh.p.k., datë 20.2.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2019, drejtuar “\*\*\*\*” sh.p.k;
- Kthim përgjigje “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 2.4.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2019, drejtuar “\*\*\*\*” sh.p.k;
- Kthim përgjigje “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 15.5. 2019
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2019, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër;
- Kthim përgjigje Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2019, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër;
- Kthim përgjigje DRSSH-ja Shkodër, nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2019, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda;
- Kthim përgjigje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2019;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2019 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Kthim përgjigje DPPP-ja, nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2019.

## Arsyetim ligjor

- A. Më datë 29.4.2013 me kontratë shitblerje, nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., apartament me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, me sipërfaqe të hipotekuar 62.72 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 8.28 m<sup>2</sup>, dhe sipërfaqe ndërtimi 71 m<sup>2</sup> për çmimin 16.307 USD.

Në pikën 2.4 të nenit 2 të kësaj kontrate përcaktohet se kryerja e pagesës ka përfunduar në vitin 2002.

Nga ana e ZVRPP-së konfirmohet fakti se ky apartament është në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe në kartelën e pasurisë të kësaj pasurie tek seksioni “përshkrimi i veçantë” ka shënimin: *pasuria rivlerësohet me raport vlerësimi në vlerën 6,250,000 lekë.*

1. Më datë 30.4.2013, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet një shkrese ka kontestuar çmimin e vendosur në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, pasi, sipas tij në bazë të kontratës paraprake nr. \*\*\*, çmimi i apartamentit është vendosur 5,000,000 lekë.

Ai ka kërkuar korrigjimin e çmimit, duke i kërkuar shoqërisë së ndërtimit të vihej çmimi real i shitjes që korrespondon dhe me pagesën e kryer nëpërmjet bankës, më datë 1.12.2011. Në këtë shkresë, nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk kontestohet viti i pagesës, i cili është shënuar 2002.

Ndërkohë, kontrata nr. \*\*\*, e cila është kontestuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, bazuar në aplikimin me kërkesën nr. \*\*\*, datë 3.5.2013, rezulton të jetë dorëzuar pranë ZVRPP-së Tiranë për të bërë regjistrimin e këtij apartamenti në emër të tij. Pas regjistrimit të apartamentit, subjekti i rivlerësimit, më datë 31.5.2013, ka aplikuar për rivlerësimin e sendit të paluajtshëm.

Për sa më sipër, rezultoi se ka një mospërputhje midis çmimit të blerjes të përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe çmimit real të paguar nga ana e subjektit të rivlerësimit të përcaktuar dhe në kontratën e sipërmarrjes, si dhe të datës së shlyerjes së këtij çmimi.

Në lidhje me këtë konstatim është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili sqaron se:

*“Çmimi dhe data janë vënë gabim nga ana e firmës “\*\*\*\*” sh.p.k., në kontratën e shitjes dhe unë këtë e kam kontestuar. Kontrata e sipërmarrjes, data dhe pagesa prej 5 milion lekë e hedhin poshtë këtë paragraf.*

*Kontestimin tim firma “\*\*\*\*” sh.p.k., e ka pranuar me shkrim, por nuk i bëri korrigjimet asnjëherë. Unë i propozova një amendim të kontratës për diferencën e çmimit të munguar, por firma nuk e mori parasysh dhe kontrata e shitjes mbeti në gjendjen me vlerën 16.307 USD.*

*Meqenëse për marrjen e kredisë kisha një kolateral që nuk ishte pronë e imja, doja që ta zhbillokoja për ta kthyer te i zoti, pasi të merrja hipotekën e apartamentit tim.*

*Me marrjen e hipotekës së apartamentit më datë 3.5.2013, në konsultim me ZVRPP-në m'u sugjerua të bëja një rivlerësim të pronës për ta kthyer në vlerën reale që do të më shërbente edhe për zëvendësimin e kolateralit. Pasi mora raportin e rivlerësimit në datën 29.5.2013 aplikova në ZVRPP për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme më datë 31.5.2013, ku kam paguar në bazë të mandatit bashkëngjitur edhe tatimin prej 45.007.49 lekë për diferencën e shtuar të çmimit prej 4.500.749 lekë nga 16.307 USD (1.749.251 lekë). Mbas këtij veprimi*

*apartamenti është konsideruar nga ZVRPP-ja i rivlerësuar me çmimin 6.250.000 lekë. Bashkëngjitur vërtetimi hipotekor datë 31.5.2013, si dhe mandati i pagesës së tatimit.”*

Subjekti ka bashkëlidhur:

- Vërtetimi nga dokumentet hipotekore, datë 31.5.2013, ku në seksionin “komente nga regjistruesi” është shënimi: *pasuria rivlerësohet me raport rivlerësimi në vlerën 6, 250,000 lekë, datë 31.5.2013;*
- Mandatpagesë “Credins Bank”, datë 3.5.2013, në vlerën 60, 839 lekë;
- Mandatpagesë “Credins Bank”, datë 3.5.2013, në vlerën 1,882 lekë;
- Mandatpagesë “Credins Bank”, datë 3.5.2013, në vlerën 6,000 lekë;
- Mandatpagesë “Credins Bank”, datë 31.5.2013, në vlerën 45,007 lekë për pagesën e tatimit të rivlerësimit të pasurisë ;
- Tabelë e llogaritjes së rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

Ndërkohë nga ana e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në lidhje me konstatimet e mësipërme sqarohet se:

*“Gabimisht nga ana e stafit tonë në kontratën e shitblerjes është vendosur vlera e referencës së këtij apartamenti sipas vitit 2002, gabim i cili u bë i pamundur të korrigohej edhe pas kontestimit nga ana e klientit, pasi ishte aplikuar në ZVRPP-në Tiranë dhe nuk gjetëm asnjë zgjidhje ligjore për ta korrigjuar. Nëse do të gjendet zgjidhja ligjore jemi të gatshëm në çdo moment për ta korrigjuar vlerën pasi jemi në vështirësi para klientit.”*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, rezulton e provuar se më datë 30.4.2013 subjekti i rivlerësimit nëpërmjet një shkrese ka kontestuar çmimin e vendosur në kontratën e shitblerjes, duke kërkuar korrigjimin e çmimit, pasi, sipas tij, në bazë të kontratës paraprake, çmimi real i apartamentit është vendosur 5,000,000 lekë. Pavarësisht kërkesës së subjektit, çmimi nuk është ndryshuar në kontratën e shitblerjes, ndërkohë nga ana e tij janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për rivlerësimin e pasurisë, duke korrigjuar në këtë mënyrë çmimin e apartamentit.

2. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se për gjatë viteve kishin ndryshuar porositësit (porositës i fundit ishte z. A. G.) e këtij apartamenti, deri në momentin e kalimit të tij tek subjektit me kontratën e sipërmarrjes të datës 9.12.2011, të lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe subjektit të rivlerësimit, çmimi i përcaktuar në kontratë është 5,000,000 lekë.

Në lidhje me marrëdhënien e krijuar për blerjen e këtij apartamenti midis subjektit të rivlerësimit dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe porositësit të fundit të këtij apartamenti z. A. G., është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka sqaruar se:

*“Unë kam lidhur kontratën e sipërmarrjes në datën 9.12.2011 me firmën e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., pasi kjo firmë me njoftoi për një okazion shitje të apartamentit në fjalë nga z. G., i cili ishte ndërtuar nga firma “\*\*\*\*”, por nuk kishte marrë akoma pronësinë me hipotekë, prandaj u bë ndërmjetës firma “\*\*\*\*” për këtë shitje. Kështu, marrëveshja për shitjen e apartamentit nga z. G., te unë dhe likuidimi nuk është bërë direkt midis meje dhe z. G., por nëpërmjet firmës “\*\*\*\*” në datën 7.12.2011.*

*Kjo gjë vërtetohet edhe me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, të datës 7.12.2011 të z. G., ku shprehet se nuk ka asnjë pretendim financiar dhe është i shlyer tërësisht me firmën “\*\*\*\*”.*

*Gjithashtu ai shprehet se është likuiduar nga unë me vlerën e plotë të apartamentit (gjithnjë me miratimin e firmës “\*\*\*\*”), pasi ishte kjo firmë që kishte në dispozicion pagesën time të transferuar në datën 2.12.2011 me bankë për shumën 5 milion lekë.  
Bashkëngjitur deklaratë \*\*\* e z. G., me paragrafët përkatëse që kam cituar më lart.”*

Ndërkohë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sqaron:

*“...Gjatë kësaj periudhe nga ana e klientit (subjektit të rivlerësimit) është kërkuar t'i krijonim mundësinë për të ndërruar apartamentin e porositur në \*\*\*<sup>1</sup> me një apartament qoftë dhe më të vogël, por që të ishte brenda qytetit, pasi \*\*\* ishte larg me shumë trafik dhe rrugë të prishur shumë. Gjatë kësaj periudhe një klient tjetër i joni ... për nevoja të vetat personale (shkollimin e fëmijëve në Londër) na kërkoi revokimin e kontratës. Revokimi i kësaj u krye përfundimisht më datë 7.12.2011. Këtë gjë e deklaroi vetë z. A. G., me deklaratë noteriale nr. \*\*\* në të cilën shprehet: “Deklaroj nën përgjegjësinë time të lirë dhe të plotë se nuk kam asnjë pretendim financiar, ligjor ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” dhe nuk pretendoj as sot e as në të ardhmen mbi pronësinë e pasurisë së mësipërme pasi jam shlyer totalisht për të. Nga ky moment ne na u lirua një apartament si fizikisht, dhe nga ana ligjore, të cilin ia rekomanduam klientit Behar Dibra, që ra dakord në parim për të ndërruar apartamentin e porositur në \*\*\* me këtë apartament që na u lirua dhe ramë dakord që të revokim kontratën e porosisë në \*\*\*, të lidhim një kontratë sipërmarrje për apartamentin në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë dhe t'i kthenim mbrapsht shumën prej 1,500,000 lekë.”*

I është kërkuar informacion shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për të vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për anulimin e kontratës së porosisë me shtetasin A. G., dhe pagesat që i kanë kryer këtij shtetasi në lidhje me apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit. Në përgjigjen e saj shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sqaron se: *“Për sa i takon marrëdhënies me z. A. G., revokimi i kësaj u krye përfundimisht në datë 7.12.2011. Këtë gjë e deklaroi vetë z. A. G., me deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 7.12.2011 në të cilën shprehet: “Deklaroj nën përgjegjësinë time të lirë e të plotë se nuk kam asnjë pretendim financiar, ligjor ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” dhe nuk pretendoj as sot e as në të ardhmen mbi pronësinë e pasurisë së mësipërme, pasi jam i shlyer totalisht. Ne i kemi shlyer z. G., të gjitha detyrimet financiare”.*

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me z. A. G., pasi ai ka lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke i likuiduar dhe çmimin e apartamentit.

3. Përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin e mësipërm, subjekti i rivlerësimit, më datë 3.5.2011, me kontratë porosie nr. \*\*\*, ka porositur tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., një apartament me sipërfaqe 86.87 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, për shumën 6,500,000 lekë.

Bazuar në nenin 3 të kësaj kontrate rezulton se me lidhjen e saj është paguar *cash* shuma prej 1, 500,000 lekë. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të paguar këtë shumë, pasi në deklaratën e interesave private të vitit 2010 ai nuk ka deklaruar gjendje *cash*.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit sqaroi se:

---

<sup>1</sup> Për më shumë detaje referohuni në pikën 3 më poshtë.



*“Shuma prej 1.500.000 lekë është paguar të firma “\*\*\*” për kontratën e porosisë të datës 3.5.2011 për llogarinë time nga daja im z. F. G. Kjo pagesë është e vërtetuar me mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 3.5.2011 nga firma “\*\*\*”. Bashkëngjitur mandati. Kjo shumë ishte një hua që unë isha i detyruar t’ia ktheja atij më vonë, pasi nuk kisha kursime apo para të lira në atë kohë.”*

**Më datë 7.12.2011**, me aktin nr. \*\*\* “revokim kontratë porosie” është revokuar kontrata e mësipërme. Në këtë aktrevokimi deklarohet se subjekti i rivlerësimit mori mbrapsht shumën prej 1,500,000 lekë.

Në lidhje me këtë revokim, subjekti i rivlerësimit sqaron se:

*“Megenëse ishte e njëjta firmë ndërtimi për të dyja apartamentet dhe u paraqit okazoni për një apartament më të vogël, me vendodhje më të mirë brenda Tiranës dhe çfarë është më e rëndësishme me vlerën që unë kisha mundësi nëpërmjet kredisë, vendosëm bashkarisht me firmën “\*\*\*”, që të bëhet revokimi i kontratës së parë dhe lidhjen e kontratës së sipërmarrjes së dytë. Paratë që ishin paguar nga kredia do të mbeteshin te firma “\*\*\*”, dhe diferenca prej 1.500.000 lekë iu kthye dajës tim nga firma “\*\*\*” brenda 7 muajve të vitit 2011.*

*Nuk është deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2011, pasi kontrata u lidh në maj të vitit 2011 dhe u revokua në 7 dhjetor të po atij viti (2011) dhe pagesa prej 1.500.000 lekë i ishte kthyer nga firma “\*\*\*”, dajës tim z. F. G., dhe se pagesa prej 1.500.000 lekë nuk ishte një shumë të hollash që unë e kisha konsumuar për nevojat e mia dhe ta kem kthyer me të ardhurat e mia. Kontratën e sipërmarrjes datë 9.12.2011 për apartamentin që kam sot, e kam deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2011.”*

Subjekti ka bashkëlidhur:

- Mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 3.5.2011, i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me emërtim paguar shuma 1,500,000 lekë nga z. F. G., për apartament 1+1, në \*\*\*, për klientin Behar Dibra. Mandati rezultoi i firmosur nga z. F. G.
- Mandatëpagesë nr. s’ka, datë 7.12.2011 i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me emërtim “kthim shume 1,500,000 lekë, klienti Behar Dibra, për revokimin e kontratës së lidhur në datë 3.5.2011”. Mandati rezultoi i firmosur nga z. F. G.

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit deklaroi se kishte marrë hua shumën 1,500,000 lekë nga daja i tij z. F. G., në zbatim të nenit 32/4 të ligjit 84/2016, atij iu kërkua të vinte në dispozicion dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të z. G.

Ai ka vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim, datë 25.3.2019, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me anë të të cilit vërtetohet se F. G. është administrator i kësaj shoqërie dhe ka patur pagë bruto 1,000,000 lekë në vitin 2011.
- Deklaratë individuale vjetore e të ardhurave të vitit 2011, ku rezultoi se të ardhurat bruto të z. G., kanë qenë në shumën 12, 000, 000 lekë.

Komisioni për të vërtetuar pagat e kaluara në llogarinë e z. F. G., për vitin 2010-2011, i kërkoi subjektit të vërë në dispozicion statement bankar të llogarisë së pagës së F. G.

Më datë 29.5.2019, subjekti ka depozituar një *statement* bankar të “Raiffeisen Bank”. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti konstatohet se z. G., i kanë kaluar pagat si më poshtë:

Data	Shuma
16.04.2010	200,000
05.05.2010	100,000
17.05.2010	106,730

16.06.2010	200,000
02.07.2010	100,000
16.07.2010	100,000
16.08.2010	200,000
01.09.2010	300,000
22.10.2010	500,000
01.11.2010	445,110
15.11.2010	500,000
02.12.2010	250,000
16.12.2010	250,000
17.01.2011	500,000
01.02.2011	250,000
22.02.2011	250,000
11.03.2011	500,000
<b>Total</b>	<b>4,751,840</b>

Përveç dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu një hetim administrativ të plotë në lidhje me të ardhurat e z. F. G., nga ku rezultoi se:

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër konfirmon faktin se në dhjetor të vitit 2011, paga bruto e z. G., ka qenë 1,000,000 lekë. DRSSH-ja Shkodër ka vënë në dispozicion vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të z. F. G., nëpërmjet të cilit vërtetohet se ai ka patur një pagë bruto të deklaruar në vitin 2011, për periudhën shkurt - qershor: 84,100 lekë dhe për periudhën qershor – dhjetor: 87,700 lekë.

Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se z. F. G., ka patur aftësi financiare për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit hua në shumën 1,500,000 lekë.

4. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se kontrata e furnizimit me ujë të pijshëm ishte në emër të subjektit të rivlerësimit<sup>2</sup>, ndërkohë nga ana e OSHEE-së nuk konfirmohet që subjekti i rivlerësimit të ketë lidhur kontratë për furnizimin e energjisë elektrike.

Në lidhje me këtë konstatim, pasi është pyetur, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion kontratë të furnizimit me energji elektrike, e cila ishte në emër të një shtetasi tjetër, si dhe aplikimin e datës 21.3.2019 për ndryshimin e emrit të abonentit në kontratën e furnizimit me energji elektrike.

5. Si burim për blerjen e këtij apartamenti subjekti i rivlerësimit deklaroi kredi e butë në "BKT" në shumën 5,000,000 lekë, me afat 20 vjet.

Më datë 23.11.2011, me kontratë kredie nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit ka marrë hua shumën 5,000,000 lekë.

Më datë 23.11.2011 është lidhur kontrata e hipotekimit nr. \*\*\*, me hipotekues z. B. Ll., dhe përfitues "BKT". Sipas kësaj kontrate, hipotekuesi disponon pasurinë arë me sipërfaqe 8320

<sup>2</sup> Nga ana e UKT-së konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me nr. \*\*\*

m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*; kjo pronë hipotekohet në favor të “BKT”-së për të siguruar kthimin e kredisë në shumën 5,000,000 lekë.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në “BKT”, rezulton se:

- Më datë 1.12.2011 është disbursuar kredia në shumën 4,950,000 lekë;
- Më datë 2.12.2011 është transferuar shuma 4,925,023 lekë tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.;

Për sa më sipër rezulton se pagesa për këtë apartament është bërë nëpërmjet sistemit bankar menjëherë pas disbursimit të kredisë.

**B.** Subjekti është pyetur në lidhje me pasuritë në pronësi të babait të tij, Y. D.

Me përgjigjen e tij, ai ka bashkëlidhur:

- Vërtetim negativ, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2019, i ZVRPP-së Shkodër, ku deklorohet se në emër të z. Y. D., nuk ka pasuri të regjistruara;
- Vërtetim negativ, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2019, i ZVRPP-së Shkodër, ku deklorohet se në emër të z. Behar Dibra nuk ka pasuri të regjistruara;
- Certifikatë familjare, datë 18.2.2019 e z. Y. D., ku në përbërjen e tij familjare rezulton dhe z. A. D.;
- Certifikatë familjare trangu e z. Y. D., datë 18.2.2019;
- Vërtetim pronësie e Zyrës së Noterisë – Hipotekë Shkodër, datë 1.7.1965;
- Vërtetim pronësie e Zyrës së Noterisë – Hipotekë Shkodër, datë 1.10.1964;
- Notë-transkriptimi e Zyrës së Noterisë – Hipotekë Shkodër, datë 8.5.1964;
- Prokurë e posaçme, viti 1964;
- Prokurë e posaçme, datë 19.6.1965;
- Shkresë e Komitetit Ekzekutiv, K.P Qytetit, datë 14.8.1965;
- Vërtetim i Bankës së Shtetit Shqiptar, dega Shkodër, datë 2.12.1985;
- Certifikatë familjare trangu të z. I. D., (gjyshi i subjektit të rivlerësimit), datë 18.2.2019;
- Letërnjoftim Y. D.;
- Kartë identiteti Y. D.;
- Librezë pensioni Y. D.;
- Kontratë me OSHEE –në, në emër të I. D.;
- Librezë UKSH-je, në emër të I. D.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit rezulton se:

- Babai i tij nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar pranë ZVRPP-së Shkodër;
- Bazuar në vërtetim pronësie të datës 1.7.1965, rezulton se I. Y. D., Z. Y. D., Xh. Y. D. Xh. dhe F. Y. G., kanë në pronësi një shtëpi të ulët, me një dhomë, me pak kopsht e gjysmë pusi, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, e cila rezulton të jetë trashëguar nga babai i tyre Y. K. D., bazuar në notë-transkriptimin e Zyrës së Noterisë - Hipotekë Shkodër, datë 8.5.1964;
- Bazuar në prokurat e posaçme të vitit 1964 dhe të datës 19.6.1965, shkresës së Komitetit Ekzekutiv K.P Qytetit, datë 14.8.1965, rezulton se z. I. D., së bashku me motrat e tij ka marrë një kredi në shumën 150, 000 lekë për meremetimin e banesës.

Kjo kredi është shlyer në vitin 1985 bazuar në vërtetimin e Bankës së Shtetit Shqiptar, dega Shkodër, datë 2.12.1985;

- Kontrata e OSHEE-së dhe UKT-së janë të lidhura në emër të I. D.

C. Nga ana e Komisionit është kryer hetim nëse subjekti i rivlerësimit ka hetuar ndonjë nga personat, të cilët kanë qenë porositësit të apartamentit të blerë prej tij, përpara lidhjes së kontratës së sipërmarrjes midis tij dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e apartamentit. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka ardhur përgjigje negative.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklaram. Të dhënat e referuara prej tij, konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Në lidhje me këtë pasuri nuk lindin dyshime apo paqartësi.

### **Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit**

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Behar Dibra ka qenë i saktë në deklaramin e tij në deklaratën “Vetting”.

Komisioni çmon se subjekti, ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Behar Dibra, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

**Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 17.5.2019. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**Si konkluzion DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Behar Dibra.**

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gyyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në menyre të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Behar Dibra, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me

persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të hartuar, duke u bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënave nga 23 prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.
- 4) Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- 5) Denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Pranë Komisionit janë paraqitur 3 denoncime. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Pas analizimit të dokumentacionit të mësipërm, Komisioni vlerëson se:

#### **1. Aftësitë profesionale**

##### **a) Njohuritë ligjore**

Në 3 (tri) dokumentet ligjore dhe në 5 (pesë) dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ai ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të plota. Gjithashtu ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional.

##### **b) Arsyetimi ligjor**

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Respektohen përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

## **2. Aftësitë organizative**

### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Duke iu referuar vërtetimit nr. \*\*\*, datë 11.12.2018 dhe listës së statistikave, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve të datës 12.12.2018, konstatohet se janë 61 (gjashtëdhjetë e një) çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit të marra në shqyrtim për shortim. Duke patur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve që trajtohen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, konstatohet se, subjekti i rivlerësimit është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke marrë vendime brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

Afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Në analizë e të dhënave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në përgjithësi ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës.

### **b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore**

Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit, ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

### **c) Aftësia për të administruar dosjet**

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe 5 (pesë) dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se, subjekti i rivlerësimit, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

## **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### **a) Etika në punë**

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, për subjektin nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth etikës në punë.

### **b) Integriteti**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

**c) Paanësia**

Nga 3 (tri) dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 (pesë) dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu në asnjë prej 3 (tri) dokumenteve ligjore dhe 5 (pesë) dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 (tri) dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 (pesë) dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

**4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

**a) Aftësitë e komunikimit**

Në 3 (tri) dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 (pesë) dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

**b) Aftësia për të bashkëpunuar**

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

**c) Gadishmëria për t'u angazhuar**

Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, si për ngritjen e nivelit profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit, duke u vlerësuar me certifikatat përkatëse.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Behar Dibra, konstatohet se ky subjekt ka treguar cilësi të mira në punë, arsyetim dhe gjykim të drejtë, identifikon dhe analizon drejt problemet, si dhe respekton në arsyetim të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv.

**D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha

pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, konstaton se subjekti ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Behar Dibra.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 25.6.2019.



### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela ZHEGU**  
Kryesuese



**Etleda ÇIFTJA**  
Anëtare

**Sekretare gjyqësore**  
**Fiorela MANDRO**

**Genta TAEA (BUNGO)**  
Relatore